



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:123275

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06216268

KF.nr.201/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Vali”, Sh.P.K., me numër unik identifikues 811168550 dhe seli në Gllogovc, të cilin me autorizim e përfaqëson Salih Gjonbalaj, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlera e kontestit e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 17.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Vali”, Sh.P.K., me seli në Gllogovc, si e pabazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.90/2021, i datës 30.04.2021, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Vali”, Sh.P.K., me seli në Gllogovc, me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr.90/2021 të datës 30.04.2021 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia, të anulohet vendimi nr.90/2021 i datës 30.04.2021 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, të obligohet e paditura që ta liroj nga qarkullimi i

tatimit shtesë që ka rezultuar nga raporti i kontrollit i datës 29.01.2021 dhe të obligohet e paditura të paguaj shpenzimet e avokatit sipas T/A të OAK-së. Tutje në padi ka theksuar se e paditura edhe pse e ka aprovuar ri kontrollin nuk i ka marr për bazë provat dhe fakte, dhe gjatë vlerësimit të ri kontrollit ka nxjerr këto rezultate, edhe pse në arsyetimin e vendimit me nr.90/2021 të datës 30.04.2021, nuk qëndrojnë dhe nuk janë të bazuara në gjendjen reale të kësaj çështje sepse dëshmitë e ofruara nga ana e paditësit janë ofruar bazuar në gjendjen reale, ndërsa e paditura ka cekur dhe bërë ngarkimin me qarkullim shtesë dhe theksojmë se në bazë të provave e paditur ka bërë shkelje të procedurës sepse ri kontrolli ia ka bashkangjitur vetëm pasqyrat të kontrollit paraprak.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 18.02.2022, thekson se si palë e paditur në këtë konflikt administrativ, i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi, si të pabazuara në ligj dhe vlerëson se vendimi i Departamentit të Ankesave me nr.90/2021 është bazuar në prova konkrete dhe dispozita ligjore që janë në fuqi. Tutje në përgjigje në padi ka theksuar se lidhur me pikat kontestuese të tatimpaguesit të cilat nuk janë pranuar me vendimin e DA-së konstatojmë se kontrolli ka vepruar drejtë dhe bazuar në dispozita ligjore në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar-administrativ konform dispozitave të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në mungesë të palëve ndërgjyqëse, pasi pala paditëse, edhe pse e ka pranuar ftesën për seancën e datës 17.09.2024, nuk e ka arsyetuar mungesën e saj. E paditura, nga ana tjetër, ka njoftuar Gjykatën më parashtrësën e datës 16.09.2024 se nuk do të marrë pjesë në seancë, duke kërkuar që gjykata të veprojë në përputhje me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. Ajo ka kërkuar gjithashtu që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi nr.90/2021 të mbetet në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 17.09.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimin nr.116/2020 të datës 28.10.2020, Vendimin nr.90/2021 të datës 30.04.2021, Ankesë e paditësit ndaj raportit të kontrollit e datës 04.03.2021, Përgjigje në padi, Njoftimi për seancë në DA e datës 22.03.2021, Procesi i seancës së datës 29.03.2021, Formë për vizitat përmbushëse e datës 08.01.2021, Libri i blerjes 2015, Raporti i kontrollit i datës 29.01.2021, Gjendja e borxheve, Pasqyra e tatimpaguesit dhe Ekspertiza financiare e datës 05.06.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, nga deklaratimet në padi, deklaratimet nga përgjigja në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues dhe Raportin e Kontrollit nr. dosjes 8582 të datës 29.01.2021. Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se i padituri ka ushtruar kontroll tek këtu paditësi për periudhat: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar TVSH 04/2015-10/2019, Tatimi në të Ardhura të Korporatave TAK 2015-2018, Pasqyrë e mbajtëses në burim WM 2015-2019, pasqyrë e kontributeve CM për 04/2015-10/2019. Nuk është kontestues as fakti se këtu paditësi ka ushtruar ankesë me datë 04.03.2021 në Divizionin e Ankesave në ATK, e për të cilën ankesë këtu e paditura me datë 30.04.2021 ka marr vendimin nr.90/2021, si akt administrativ përfundimtar në të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit, dhe ka ndryshuar Njoftim Rivlerësimi për Tatim në të Ardhurat të Korporatave për vitin 2017, sa i përket njohjes për kosto të blerjeve që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt, ndërsa pjesa tjetër e vlerësimit ka mbetur e pa ndryshuar, e kundër këtij vendimi këtu paditësi, me datë 17.06.2021 ka ushtruar padi në Gjykatë.

Nga shqyrtimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit me nr. 90/2021 të datës 04.03.2021. ATK ka ndryshuar Njoftimin për Rivlerësimin e Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatave për vitin 2017, duke njohur koston e blerjeve që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt. Pjesa tjetër e vlerësimit ka mbetur e pandryshuar, me arsyetimin se kërkesa e tatimpaguesit për njohjen e blerjeve në vlerë tatueshme prej 51,724.14 euro për periudhën 07/2015 është shqyrtuar nga Divizioni i Ankesave, i cili ka konkluduar se kontrolli e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë.

Në lidhje me mosnjohjen e blerjeve sipas faturës nr. 12/2015 në vlerë tatueshme prej 77,856.87 euro nga biznesi “Arbëri NS” Sh.P.K., Divizioni i Ankesave ka konstatuar se fatura në fjalë nuk është

prezantuar gjatë kontrollit. Ajo është regjistruar vetëm në librin e blerjeve, dhe gjatë procedurës së kontrollit, tatimpaguesi ka deklaruar se kjo blerje nuk ekziston (dëshmi AU005, datë 08.01.2021).

Për sa i përket kontestit të tatimpaguesit për ngarkesën me qarkullim shtesë për faturat nga subjekti “Aktiv” Sh.P.K., për periudhën Tetor-Dhjetor 2015, si dhe faturat nga subjekti “RUB” Sh.P.K. për periudhën Korrik 2016, tatimpaguesi e ka konsideruar vlerësimin të padrejtë. Divizioni i Ankesave ka konstatuar se këto fatura janë njohur si kosto biznesi dhe janë regjistruar si shitje, në mungesë të argumentimit të mjaftueshëm nga tatimpaguesi.

Tatimpaguesi gjithashtu ka kontestuar ngarkesën shtesë bazuar në një import të cilin pretendon se nuk i përkiste atij si kompani. Megjithatë, tatimpaguesi nuk ka paraqitur dëshmi në lidhje me këtë çështje, si p.sh. ndonjë procedurë gjyqësore të nisur për keqpërdorim të certifikatës së TVSH-së. Tatimpaguesi nuk ka marrë pjesë as në seancën dëgjimore ku do të mund të paraqiste dëshmi shtesë për të mbështetur pretendimet e tij.

Për kontestin mbi qarkullimin shtesë për periudhën Dhjetor 2016, ku kontrolli ka marrë për bazë vetëm vlerat e blerjeve të deklaruara mbi 500.00 euro nga subjekti “Arbëri NS” dhe ka injoruar kartelën me subjektin, Divizioni i Ankesave konstaton se kontrolli ka gjetur që “Arbëri NS” kishte deklaruar blerje prej 23,299.15 euro. Pas verifikimit të dokumentacionit dhe pagesave bankare, u konstatua një diferencë prej 3,967.17 euro, e cila është trajtuar si shitje shtesë.

Kontestimi mbi mospërputhjen e blerjeve dhe kostos së njohur për vitin 2016, duke përfshirë shpenzimet e ndryshme, u shqyrtua nga Divizioni i Ankesave. Në bazë të Deklaratës së TVSH-së për vitin 2016, rezulton se blerjet dhe importet pa TVSH ishin 5,599.49 euro, blerjet vendore me normë 18% ishin 295,249.10 euro, importet investive me normë 18% ishin 14,555.00 euro, ndërsa blerjet dhe importet investive pa TVSH ishin 15,941.80 euro.

Sa i përket kontestit për qarkullim shtesë për vitin 2017, Divizioni i Ankesave ka verifikuar se kontrolli ka njohur të gjitha blerjet e padeklaruara nga tatimpaguesi si kosto të periudhës përkatëse. Në mungesë të provave për artikujt e përfshirë në faturat në fjalë, këto janë trajtuar si shitje me marzhë 15%, sipas deklarimeve të vet tatimpaguesit.

Kontesti për qarkullimin shtesë për vitin 2018 ka pasur të njëjtin trajtim, ku kontrolli ka njohur të gjitha blerjet si të ligjshme dhe me TVSH të zbritshëm. Në mungesë të dokumentacionit për deklarimin e artikujve të blerë, këto janë trajtuar si shitje me marzhë 15%.

Sa i përket pretendimit për mospërfshirjen e shpenzimeve të interesit nga kredia e marrë për nevoja biznesore, Divizioni i Ankesave vëren se tatimpaguesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme që të kërkohej verifikimi i destinimit të kredisë nga ana e kontrollit.

Në lidhje me kontestin për qarkullimin e periudhës 04/2018, bazuar në llogaritë bankare TEB nga subjekti “Graniti”, i cili sipas paditësit ishte një anulim transferi dhe jo pagesë, Divizioni i Ankesave ka verifikuar se kjo çështje nuk është trajtuar fare në ri-kontroll.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.201/22 të datës 16.02.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontekst tregtar administrativ me ekspertin financiar M.B. me detyra përkatëse.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 05.06.2024, është dhënë mendimi profesional ku i njëjti ka konstatuar se: *“Edhe përkundër komunikimit të vazhdueshëm me përfaqësuesin e autorizuar nga pala paditëse “Vali” SH.P.K, për kompletimin dhe argumentimin e dokumentacionit të nevojshëm për vlerësim, nuk kam pranuar asnjë dokumentacion krahasues nga ana e paditësit, vlerësimi final nga eksperti financiar sipas dokumentacionit dhe shkresave në lëndën gjyqësore, referuar bazës ligjore dhe dispozitave ligjore të Ligjit nr.03/L-22 mbi Administratën Tatimore, mbetet i njëjtë me Raportin e Kontrollit të datës 29.01.2021. Arsyetimet nga ana e palës paditëse ishin të pa mjaftueshëm dhe të pa dokumentuara qoftë në formë elektronike apo edhe fizike dhe ishte e pa mundur për të ndryshuar raportin dhe dhënien e një vlerësimi profesional për çështjet që ishin objekt kontestues ”.*

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të datës 28.08.2024 eksperti financiar M.B. ka deklaruar: *“Qëndrojë pranë konstatimeve në ekspertizë dhe kjo për faktin se nuk kam pasur dokumentacion*

*krahasues që të nxjerrët një konstatim tjetër, andaj sipas dokumentacionit të lëndës konstatimi im është se raporti i kontrollit i të paditurës është i rregullt. Nga data kur jam caktuar si eksperte për këtë lëndë përkatësisht nga muaji shkurt deri në muajin qershor e kam përshkruar komunikimin e vazhdueshëm me përfaqësuesin e paditësit nga i cili kam kërkuar dokumentacionin dhe nuk kam marrë përgjigje, ky komunikim po ashtu i është bashkangjitur ekspertizës si dëshmi për komunikimet në fjalë. Po ashtu me përfaqësuesit e ATK kam pasur takime dhe kam kërkuar dokumentacionin në të cilin ata janë bazuar por në mungesë të dokumentacionit nga pala paditëse ka qenë e pamundur të bëhet një krahasim për një konstatim tjetër nga ai i të paditurës. Me avokatin jemi takuar disa herë dhe komunikimi me të ka qenë korrekt, mirëpo dokumentacionin e kërkuar nuk e ka poseduar dhe nuk ka mundur të dorëzojë”.*

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare 05.06.2024 të ekspertit financiar M.B. në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë.

Gjykata i vlerësoj të pabazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, ekspertizën financiare të datës 05.06.2024, si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Në seancën e datës 28.08.2024, përfaqësuesi i paditësit deklaroi se ekspertiza financiare ka nevojë për plotësim, jo për fajin e ekspertit, por për shkak të disa mangësive që lidhen me dokumentet e palës që ai përfaqëson. Ai sqaroi se që nga seanca e fundit, kur ai kishte kërkuar sigurimin e dokumenteve përkatëse, përfshirë librat kontabël dhe disa fatura që janë pjesë e objektit të çështjes, klienti i tij nuk kishte qenë në gjendje t'i siguronte ato. Arsyeja për këtë vonesë ishte se paditësi ndodhej jashtë shtetit për shkak të problemeve shëndetësore të djalit të tij, duke e bërë të pamundur sigurimin e provave të rëndësishme në kohën e duhur. Me tej ka sqaruar se pas disa përpjekjeve për të kontaktuar me paditësin, përfaqësuesi deklaroi se ka arritur të flasë me të katër ditë më parë, kur paditësi ishte kthyer në Kosovë. Gjatë këtij kontakti, ai e informoi me përmbajtjen e ekspertizës, dhe paditësi premtoi se do të siguronte dokumentet e kërkuara për të mundësuar plotësimin e ekspertizës dhe se do të angazhojë kontabilistin e tij për të mbledhur dokumentet e nevojshme. Për këto arsye, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit kërkoi që gjykata të aprovojë plotësimin e ekspertizës

në bazë të dokumenteve që pritet të dorëzohen, me qëllim që gjykata të ketë një provë të besueshme dhe të përpunuar sipas standardeve profesionale.

Si rrjedhojë e deklarimeve të mësipërme, Gjykata e ka obliguar përfaqësuesin e paditësit që në afat prej pesë ditëve ti ofrojë gjykatës dëshmitë se pala paditëse prej periudhës 29.02.2024, nga kur është kërkuar dokumentacioni nga ekspertja financiare ka qenë jashtë shtetit, por i njëjti nuk ka vepruar në bazë të kërkesë së gjykatës, andaj meqenëse brenda afatit të parapara paditësi nuk ka sjell dëshmitë e kërkuara, në mungesë të dokumentacionit krahasues nga ana e palës paditëse, Gjykata në seancën e datës 17.09.2024 ka refuzuar propozimin për plotësimin e ekspertizës dhe ka vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo çka është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Duke marrë për bazë faktin se gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 1, të LKA-se, nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur, kjo për faktin se paditësi në këtë kontest tregtar-administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar-administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e*

*tilla*". Ndërsa me nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se *"Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta"*.

Mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se vendimi nr.90/2021 i datës 30.04.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.201/22 datë 17.09.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.